

## **Nderhyrje e deputetit Sali Berisha**

16.01.2023

**Lindita Nikolla** – Zoti Berisha, kjo nuk është procedurë.

**Sali Berisha** - Zonjë, ne nuk kemi detyrë tjetër përveç kontrollit, ne nuk kemi asnjë tagër tjetër. 620 mijë shqiptarë, të cilët kanë votuar kundër jush, kanë votuar për ne që t'ju kontrollojmë, kaq kemi ne në dorë.

Ju bëni gjithçka që të na bllokoni kontrollin, por ju garantoj, thuaja Edi Ramës, se në mënyrë absolute kjo nuk do të pranohet. Të marrë fund kjo praktikë. Ne nuk duam t'ju bllokojmë asgjë juve, por ju doni të na bllokoni ne. Ju e dini se ai ka firmosur sikur të jetë kryetar i një organizate kriminale. Ju e dini se ai ka udhëtuar 137 herë, më shumë se çdo sheik në botë, me avion me dhomë gjumi. Çfarë doni të na bëni ju?! Ne stoli nuk na bëni.

Zonjë, kërkoj nga ju që të mos i shkelni rregullat themelore të parlamentit! Absolutisht, unë nuk do të merrem me ty. Këtë ta garantoj, sepse ti je një grua, një zonjë dhe mua nuk më shkon që të përdor këtë platformë, por unë gjithçka do t'ia kthej në fytyrë atij që të menaxhon ty në këtë mënyrë. Unë nuk merrem me ty, ti bëj ç'të duash, merrem vetëm me Edi Ramën, sepse ai i stis të gjitha këto. A e morët vesh ju tani? I teket atij dhe thotë 4 deputetë të përjashtohen nga ky grup...

Të nderuar deputetë, Zonja deputete,

Të dashur qytetarë dhe qytetare, që ndiqni këtë seancë, ky parlament është shndërruar në një dhunues madhor dhe amoral të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Ky parlament, për shkak të një personi, i cili e ka inkriminuar veten nga këmbët te koka, funksionon në kundërshtim me çdo parim të parlamentit të një vendi të lirë.

Ky parlament u mohon deputetëve të drejtën e tyre legislative dhe të drejtën e tyre kushtetuese. Ky parlament është shndërruar i tëri në funksion të një njeriu, i cili ka si fjalor të vetëm dhe argument të vetëm sharjen, sharjen si një ordiner.

Prej disa muajsh kam paraqitur ligjin për heqjen e parashkrimit për kryeministrat. Kur këtë kërkesë e bën një ish-kryeministër, në çdo parlament tjetër kjo do të përshëndetej, por ju nuk

guxoni, sepse e dini që kreu juaj kryeson një organizatë kriminale. Ju nuk guxoni, sepse i keni të mbushur dyshekët, frigoriferët, lavatriçet dhe kontot me paratë e vjedhura.

A mund t'ju pyes: Niko, a ka ardhur Rozeta në shtëpinë tënde ndonjëherë? Zonjë, a ka ardhur Rozeta tek ti ndonjëherë? Të kujt janë ato 400 mijë eurot? Ulsi, po ty të ka ardhur ndonjëherë sepse edhe për ty thonë këta të tutë që të ka ardhur në shtëpi? Po Ballukja ku është?

Zonjë, ne nuk kemi detyrë tjetër përveç kontrollit, ne nuk kemi asnjë tagër tjetër. 620 mijë shqiptarë, të cilët kanë votuar kundër jush, kanë votuar për ne që t'ju kontrollojmë, kaq kemi ne në dorë.

Ju bëni gjithçka që të na bllokoni kontrollin, por ju garantoj, thuaja Edi Ramës, se në mënyrë absolute kjo nuk do të pranohet. Të marrë fund kjo praktikë. Ne nuk duam t'ju bllokojmë asgjë juve, por ju doni të na bllokoni ne. Ju e dini se ai ka firmosur sikur të jetë kryetar i një organizate kriminale. Ju e dini se ai ka udhëtuar 137 herë, më shumë se çdo sheik në botë, me avion me dhomë gjumi. Çfarë doni të na bëni ju?! Ne stoli nuk na bëni.

Zonjë, kërkoj nga ju që të mos i shkelni rregullat themelore të parlamentit! Absolutisht, unë nuk do të merrem me ty. Këtë ta garantoj, sepse ti je një grua, një zonjë dhe mua nuk më shkon që të përdor këtë platformë, por unë gjithçka do t'ia kthej në fytyrë atij që të menaxhon ty në këtë mënyrë. Unë nuk merrem me ty, ti bëj ç'të duash, merrem vetëm me Edi Ramën, sepse ai i stis të gjitha këto. A e morët vesh ju tani? I teket atij dhe thotë 4 deputetë të përjashtohen nga ky grup...